

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Nr.prot_____ prot.

Tiranë, më _____2025

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

2. Emri: Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik, Bashkia Tiranë
3. Adresa: Adresa: Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri
4. Tel/Fax: 0699693035
5. E-mail: nadia.mucelli@tirana.al, prokurimeDPKZ@tirana.al

6. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Nadia Muçelli

E mail nadia.mucelli@tirana.al; prokurimeDPKZ@tirana.al;

2.Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-38898-02-21-2025

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje mish dhe organe për ushqimin e kafshëve

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 15110000-2 – Mish

6.Fondi limit: 11 666 667 (Njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa tvsh.

7.Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 11.03.2025 ora 09:00

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ervis RAHMANI

8. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

Në mbështetje të Nenit 75, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet se: *“Autoriteti ose Enti Kontraktor nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për cfarëdo lloj arsyeje me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, (kërkesa për sqarim/saktësim të paraqitura nëpërmjet SPE – së) mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce”,* për procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje mish dhe organe për ushqimin e kafshëve, me Fondilimit: 11 666 667 (Njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa tvsh,** vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë. Autoriteti Kontraktor vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit përmes hartimit të një Shtojce, bazuar në rekomandimet që ka sjellë APP nëpërmjet email dhe e protokolluar nga DPKZ me nr. Prot 151/9 datë 04.03.2025, e cila u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për Ta, si më poshtë vijon:

Mbështetur në përcaktimet e nenit 75, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, **Autoriteti Kontraktor nuk duhet të anullojë procedurën,** por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë, në Dokumentet Standarde të Tenderit të publikuara në SPE.

ISHTE

Në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik, AK ka kërkuar: *“Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e fundit të kontratës të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

BËHET

Në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik *“Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e fundit të kontratës të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

ISHTE

Në pikën 2.1.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“UNI 10854:99 H.A.C.C.P. për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P (për Higjenën); Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore; ose ekuivalente”.*

Në lidhje me këtë kriter, AK duhet të mirëargumentojë ligjërisht dhe teknikisht kërkesën për certifikatën UNI 10854:99 pasi kjo lëshohet nga ente italiane.

Ndërkohë, sugjerojmë që AK, në zbatim edhe të pikës II.b të Rekomandimit të përbashkët të APP dhe AKU nr. 10181, datë 19.11.2018, “Mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, për të garantuar përmbushjen e

kriterit mund të kërkojë/pranojë që produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe respektim të standardeve të kërkuara në akt ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HAÇP. (edhe nëpërmjet ekuivalentet e certifikatës H.A.C.C të standardeve SSH, EN, etj).

BËHET

HIQET PIKA 2.1.6 ” Në pikën 2.1.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “UNI 10854:99 H.A.C.C.P. për sistemin e menaxhimit të autokontrollit në parimet H.A.C.C.P (për Higjenën); Për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore; ose ekuivalente”.

ISHTE

Në pikën 2.2 të DT, AK ka kërkuar: “**Kandidati/Operatori ekonomik ofertues te paraqesë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:**

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,

Kodin II.1.B, lidhur me shitjen me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve.

*Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, **Nënkategoria: II.1.A***

Sipas rekomandimit të përbashkët të APP dhe AKU të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër. Rrjedhimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kriter sipas marrëveshjes që palët kanë rënë dakort në kontratën e bashkëpunimit, duhet të plotësohet konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi”.

Nisur nga objekti i prokurimit “Blerje mish dhe organe për ushqimin e kafshëve”, sugjerojmë AK të rishikojë ose në të kundërt të mirëargumentojë teknikisht licencën e kërkuar si dhe nënkategorinë e saj, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e Vendimit Nr. 724, datë 20.11.2024 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin Nr. 805, datë 20.12.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për Licencat Dhe Lejet Që trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të përbashkëta”, si dhe të konsultohet me faqen e QKB në lidhje me informacionin mbi licencat dhe lejet.

BEHET

HIQET Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,

2.2Kandidati/Operatori ekonomik ofertues te paraqesë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Kodin II.1.B, lidhur me shitjen me shumicë e produkteve shtazore dhe të nënprodukteve.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, e grupit 3, kategoria II.1 : ” Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve.Nenkategoria: ”Shitje me shumice e ushqimeve me origjinë shtazore(per njerëz), Kodi II.1.B,

Sipas rekomandimit të përbashkët të APP dhe AKU të datës 19.11.2018 ,pika a.2 nuk lejohet përdorimi i licencës së një operatori tjetër. Rrjedhimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kriter sipas marrëveshjes që palët kanë rënë dakort në kontratën e bashkëpunimit, duhet të plotësohet konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

ISHTE

Në pikën 2.3.3 të kapaciteit teknik, AK ka kërkuar: ”Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 punonjës për të realizuar shërbimet e kërkuara, si më poshtë:

2 (dy) shoferë

2 (dy) punëtorë

1 (një) veteriner

Për punonjësit e kategorisë shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme si dhe leja e drejtimit për çdonjërin.

Për punonjësin e kategorisë veteriner të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit me kodin përkatës.

Për punonjësit e kategorisë punëtor të paraqitet kontrata e punës.

Së pari, lidhur me kërkesën për disponimin e “1 (një) veteriner”, APP sugjeron të argumentohet ligjërisht dhe teknikisht kjo kërkesë, duke iu referuar legjislacionit të fushës, mbi disponimin e punonjësit në fjalë.

Së dyti, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (**disponimin e punonjësve**), sugjerojmë që AK t’i përmbahet rigorozisht përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon **ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese** të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

BEHET

Në pikën 2.3.3 të kapaciteit teknik, AK ka kërkuar: ”Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 punonjës për të realizuar shërbimet e kërkuara, si më poshtë:

2 (dy) shoferë

2 (dy) punëtorë

1 (një) veteriner

Për punonjësit e kategorisë shofer të paraqitet kontratë pune e vlefshme si dhe leja e drejtimit për çdonjërin.

Për punonjësin e kategorisë veteriner të paraqitet kontrata e punës, diploma si dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit me kodin përkatës.

Për punonjësit e kategorisë punëtor të paraqitet kontrata e punës.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon **ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese** të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”

Së pari, lidhur me kërkesën për disponimin e “1 (një) veteriner”,

Argumentim.Kriteri i mësipërm është në përputhje me parashikimet e neni 41 pika 4 dhe pika 6 Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; është kërkuar me qëllimin që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit dhe realizimit të shërbimit.

Sqarojmë se :

Është e rëndësishme 1 (një) veteriner sepse :

Mishi i kërkuar përdoret I gjallë, siç vjen, pra nuk kalon në procesin e zierjes që në fakt ngordh shumicën dërrmuese të bakterieve dhe viruseve. Rrjedhimisht, mendojmë që roli I veterinerit është i rëndësishëm për dy aspekte themelore:

1. Siguria Ushqimore: Veterinerët janë të trajnuar për të njohur dhe menaxhuar sëmundjet e kafshëve që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore. Ata sigurohen që kafshët të jenë të shëndetshme përpara thertores, duke ulur rrezikun e sëmundjeve të transmetueshme.

2. Kontrolli i Cilësisë: Kërkesa për produkte specifike: mishi i kërkuar në këtë procedurë është i freskët dhe me gjak. Pra nuk është i njëjtë me atë që zakonisht tregtohet për njerëzit. Ndjekja e procesit të therjes duhet të bëhet nga një **specialist i fushës** për të minimizuar riskun e produkteve të dëmshme apo jashtë standardit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon **ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese** të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”

9. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 75, paragrafi i tretw i pikës 2 të Ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, *Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimi të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë moneta.*
Afati kohor do të shtyhet 7 dite.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 18.03.2025 ora 09:00

Vendi: ëëë.app.gov.al,

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 18.03.2025 ora 09:00

Vendi: ëëë.app.gov.al,

Konc.: S.Ndrejaj
Pranoi:..Përgj. Sektori N.Muçelli
Miratoi:..Drejtor D.Lala